



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura V
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Punë të Jashtme
Mbledhja nr. 20
Prishtinë, më 13 tetor 2015, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, sala N-302

P r o c e s v e r b a l

I mbledhjes së Komisionit për Punë të Jashtme

Në mbledhje morën pjesë: Teuta Rugova, Qerim Bajrami, Blerta Deliu-Kodra, Elmi Reçica, Ismet Beqiri.

Munguan: Enver Hoxhaj, Puhie Demaku dhe Zafir Berisha.

Nga Zyra e Komisionit: Minire Hasani, Manush Krasniqi.

Pjesëmarrës të tjerë: Kaltrina Ahmeti- GLPS; Mërgime Kajtazi- KDI; Blerta Bejtullahu-EUSR; Gurjeta Zeka - VV dhe media.

Mbledhjen e kryesoi: Teuta Rugova, zëvendëskryetare e Komisionit.

Rendi i ditës

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura, më dt. 8, 9, 10 dhe 14 shtator 2015;
3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për shërbimin e jashtëm të Republikës së Kosovës;
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesja konstatoi se Komisioni e miratoi rendin e ditës.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura, më dt. 8, 9, 10 dhe 14 shtator 2015

Kryesuesja konstatoi se, Komisioni i miratoi procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura, më 8, 9, 10 dhe 14 shtator 2015.

3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për shërbimin e jashtëm të Republikës së Kosovës

Teuta Rugova, tha se Projektligji për shërbimin e jashtëm të Republikës së Kosovës, është proceduar në Kuvend, më 14.9.2015, ndërsa u është shpërndarë deputetëve më 15.9.2015.

Bazuar në Rregulloren e Kuvendit, në cilësi të Komisionit funksional raportues, kemi obligim që ta shqyrtojmë projektligjin në parim dhe t'i paraqesim Kuvendit raport me rekomandime për miratimin ose mosmiratimin e tij në parim. Më tej, tha se projektligji përmban shkresat përcjellëse të nevojshme, memorandumit shpjegues, deklaratën financiare dhe opinionin ligjor të përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së dhe përbëhet nga 69 nene, përmban pjesën hyrëse, pjesën kryesore dhe pjesën përfundimtare.

Po ashtu, konsideroi se projektligji është i hartuar mirë dhe se qëllimi i tij është të rregullojë veprimtarinë e shërbimit të jashtëm të Republikës së Kosovës, duke përfshirë edhe Ministrinë e Punëve të Jashtme.

Me hyrjen në fuqi të këtij projektligji, parashihet të shfuqizohet Ligji për MPJ-në dhe Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës, së bashku me Ligjin për plotësimin e ndryshimin e tij, si dhe Ligji për shërbimin e jashtëm të Republikës së Kosovës. Në këtë fazë të procedurës, znj. Rugova propozoi që projektligji të përkrahet në parim dhe të formohet grupi i punës për amendamentimin e tij, në përbërje prej tre anëtarëve.

Elmi Reçica, tha se Projektligji për shërbimin e jashtëm të Republikës së Kosovës, është një draft i mirë, i cili do të mundësojë një funksionim më të mirë të shërbimit tonë të jashtëm. Përkrahu miratimin në parim të projektligjit, për të cilin tha se gjatë procedurës së shqyrtimit, mund të plotësohet dhe të ndryshohet.

Blerta Deliu- Kodra, tha se ky projektligji është me shumë interes dhe i shumëpritur. Shpreson se gjatë punës së grupit punues, projektligji do të plotësohet dhe amendamentohet, në mënyrë që të ndikojë në avancimin e punës së shërbimit të jashtëm.

Ismet Beqiri, theksoi se Projektligji për shërbimin e jashtëm të Republikës së Kosovës, është i nevojshëm. Përkrahu miratimin në parim të tij dhe shtoi se do ta japin kontributin e tyre në procedurat e mëtutjeshme të shqyrtimit të këtij projektligji.

Pas diskutimit, lidhur me shqyrtimin e Projektligjit për shërbimin e jashtëm të Republikës së Kosovës, kryesuesja konstatoi se Komisioni nxori këtë

P ë r f u n d i m

Miratohet në parim Projektligji për shërbimin e jashtëm të Republikës së Kosovës. Formohet grupi punues për shqyrtimin e Projektligjit për shërbimin e jashtëm të Republikës së Kosovës, në përbërje nga deputetët:

1. *Blerta Deliu-Kodra- kryesuese*
2. *Qerim Bajrami-anëtar*
3. *Zafir Berisha-anëtar*

4. Të ndryshme

Teuta Rugova, i njoftoi anëtarët e Komisionit se nga Komisioni për Punë të Jashtme i Kuvendit të Hungarisë, kanë ftesë për vizitë njëditore, e cila do të mund të realizohet më 17 nëntor ose 1 dhjetor. Anëtarët e Komisionit, pas diskutimit lidhur me vizitën, vendosën që vizita të realizohet më dt. 17 nëntor 2015, në përbërje nga deputetët: Elmi Reçica, Qerim Bajrami dhe dy anëtarë të tjerë të Komisionit, në propozim të kryesueses së Komisionit.

Mbledhja përfundoi në orën 10:45.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Zëvendëskryetare e Komisionit

Teuta Rugova